



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

**NJOFTIM  
PËR SHPALLJEN E KËRKESËS PËR KANDIDATURA NGA RADHËT E  
GJYQTARËVE**

**PËR KOMANDIMIN NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 79, shkronja “b”, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nenet 8, 53, 54, 57 dhe 58 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, me vendimin nr. 262, datë 16.05.2024 ka vendosur:

*“Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor për 2 (dy) pozicione “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor*

**Këshilli i Lartë Gjyqësor fton:**

Çdo gjyqtar të interesuar, që plotëson kushtet dhe kriteret e komandimit, për të paraqitur kërkesë për komandim.

Kohëzgjatja e komandimit është 2 (dy) vjet me të drejtë ripërsëritje brenda afatit 5 (pesë) vjeçar.

**Kohëzgjatja e komandimit mund të përfundojë para afatit:**

- me kërkesë të gjyqtarit, për shkaqe të justifikuara;
- kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit;
- kur ndaj gjyqtarit të komanduar merret masë disiplinore;
- kur gjyqtari i komanduar jep dorëheqjen;
- kur gjyqtari i komanduar largohet nga detyra;
- për shkak të konfliktit të interesit që mund të gjendet gjatë ushtrimit të funksionit në pozicionin si magjistrat i komanduar.

**Kriteret e komandimit janë:**

- Kandidati të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë si gjyqtar;
- Komandimi të mos bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;

- c. Kandidati të mos jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;
- d. Kandidati të mos jetë i komanduar;
- e. Kandidati që ka qenë i komanduar më parë, i) duhet të ketë shërbyer jo më pak se 5 (pesë) vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit dhe ii) nuk duhet të ketë kaluar kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës;
- f. Kandidati të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- g. Kandidati të mos jetë në kushtet e papajtueshmerisë ambientale për shkak të lidhjeve të ngushta familjare me anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Sekretarin e Përgjithshëm ose gjyqtarët e tjerë të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, sipas parashikimeve të nenit 8 pika 1 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.

#### **Ka përparësi kandidati që plotëson këto kritere:**

- a. Ka ekspertizë të veçantë në fushën e hartimit të akteve rregullatorë dhe ka përvojë në administratë publike;
- b. Ka njohuri mbi legjislacione të vendeve të Bashkimit Evropian, mbi akte ndërkombëtare dhe mbi jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare, në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe organizimin e sistemit gjyqësor;
- c. Është autor i artikujve ose botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës; Ka njohuri të mira të paktën në një gjuhë të vendeve të Bashkimit Evropian;
- d. Ka aftësi të shumë të mira profesionale, organizative, personale, si dhe etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale.

**Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është deri më datë 30.05.2024.**

#### **Kandidati duhet të paraqesë këto dokumente:**

- a) Kërkesë me shkrim për shfaqjen e vullnetit për komandim për pozicionin e shpallur;
- b) Jetëshkrimin, ku kandidati pasqyron, veç të tjerash, çdo të dhënë në lidhje me kriteret e komandimit, përveç edhe të dhënat mbi historikun e arsimimit dhe rezultatet e tij;
- c) Certifikatë/dëshmi për gjuhën e huaj;
- d) 5 (pesë) dokumente ligjore, vendime gjyqësore, artikuj apo botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës, etj.;
- e) Vetëdeklarim për mosdodhjen në kushtet e papajtueshmërisë ambientale për shkak të lidhjeve të ngushta familjare me anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Sekretarin e Përgjithshëm ose gjyqtarët e tjerë të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- f) Rekomandime për aftësitë organizative dhe të komunikimit, si dhe për të punuarit në grup;
- g) Çdo dokument tjetër që tregon plotësimin nga kandidati të kritereve të komandimit.

Dokumentacioni i aplikimit (Kërkesa për komandim dhe Vetëdeklarimin) duhet të dorëzohet nga kandidati në Zyrën e Protokollit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në adresën Rruga “Ana Komnena”, ndërtesa “Poli i Drejtësisë” Tiranë.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit, lista e kandidatëve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Të gjithë të interesuarit për më tepër informacion lidhur me procedurat e kandidimit mund të vizitojnë faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke u konsultuar me **Vendimin nr. 262, datë 16.05.2024**, “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”

**16.05.2024**